



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 18 (paragrafi 4, 8 dhe 12) të Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 20.11.2017 mori:

V E N D I M

I. Ekziston konflikt i interesit për zyrtarin e lartë z. Bahri Nuredini, Drejtor i Agjencisë për Shërbime të Navigacionit Ajror, në rastin me nr. AKK -03-02-1195/17, lidhur me mos deklarimin e konfliktit të interesit në aprovimin e komisionit për aktivitetin e prokurimit “Ndarje fizike në dhomën operative të sallës ACC/APP”, me të cilin është shpallur fitues operatori ekonomik “N.N 100 % Design” Sh.P.K, e që me pronarin e këtij operatori ekonomik z. Nuredini është bashkëpronar në biznesin “Premium Kosova Group” Sh.P.K.

II. Agjencia do të kërkoj fillimin e procedurës për kundërvajtje nga Gjykata kompetente.

III. Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në ueb faqen zyrtare të Agjencisë.

A r s y e t i m

I. Bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, neni 18 (paragrafi 1 dhe 3), është hapur rasti nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi për zyrtarin e lartë, Bahri Nuredini, Drejtor i Agjencisë për Shërbime të Navigacionit Ajror.

Pas pranimit të informacionit për dyshimin e gjendjes së konfliktit të interesit sipas të cilit z. Bahri Nuredini nga pozita e Drejtorit të Agjencisë për Shërbimin e Navigacionit Ajror i ka dhënë kontratë operatorit ekonomik “N.N 100 % Design” Sh.P.K, me pronarin e të cilit z. Nuredini kanë një biznes tjetër të përbashkët, “Premium Kosova Group” Sh.P.K.

Lidhur me këtë rast, fillimisht zyrtari i lartë z. Nuredini, është njoftuar me një shkresë zyrtare për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit.

Pas kësaj, Agjencia kundër Korrupsionit ka siguruar dosjen e tenderit “Ndarje fizike në dhomën operative të sallës ACC/APP”.

Pas shqyrtimit të dosjes së tenderit është konstatuar se zyrtari i lartë z. Nuredini gjatë ushtrimit të funksionit publik në cilësinë e Drejtorit të Agjencisë së Shërbimeve të Navigimit Ajror ka aprovuar propozimin e menaxherit të prokurimit për formimin e komisionit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndarje fizike në dhomën operative të sallës ACC/APP”, e që në këtë rast zyrtari i lartë nuk e ka deklaruar konfliktin e interesit (lidhjen biznesore me operatorin e ekonomik N.N 100% Desing Sh.P.K), për çka ka qenë i obliguar sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nr.04/L-051, neni 13 (paragrafi 1) në të cilin thuhet;

“Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publike, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij private lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit”.

Edhe pse kontratën e prokurimit e lidhur ndërmjet Menaxherit të Prokurimit dhe Operatorit ekonomik N.N 100 % Design” Sh.P.K e ka nënshkruar personi i autorizuar nga biznesi i përbashkët “Premium Kosova Group” Sh.P.K, kjo situatë cilësohet konflikt i interesit sepse është në kundërshtim me nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të interesit nr.04/L-051, në të cilin thuhet:

“Konflikti i interesit është gjendja e mospajtit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të zyrtarit të lartë, kur ai ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit publik”.

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nr.04/L-051, në nenin 9 ka përcaktuar veprimet e ndaluara të zyrtarit, ndërsa në paragrafin (7,9) shprehimisht thuhet:

Gjatë ushtrimit të funksionit publik zyrtarit të lartë i ndalohen këto veprime:

1.7 *“Të shfrytëzojë informatat e besueshme që i ka në dispozicion apo të marra në mirëbesim në ushtrimin e funksionit për përfitime personale apo për përfitime të personave të afërt apo te besueshëm”.*

1.9 *“Zyrtari i lartë nuk mund të ndërmarr veprime të cilat në ndonjë mënyrë do t'i përshtaten interesit personal të tij apo interesit të personave të afërt apo te besueshëm”.*

Ndërsa, neni 7 i këtij Ligji ka përcaktuar parimet e veprimit dhe mosveprimit të zyrtarit të lartë, ndërsa në paragrafin (3,6,8) të këtij neni shprehimisht thuhet:



3. “Zyrtari i lartë duhet ta kryej punën e tij me ndershmëri, ndërgjegje, paanshmëri, të ruajë autoritetin e zyrtarit të lartë dhe institucionit dhe me punën e tij të rrisë besimin e qytetarëve në institucione”.

6. “Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk ka të drejt të krijojë marrëdhënie varësie nga persona tjerë që do të mund të ndikonin në paanshmërinë dhe shprehjen e vullnetit të lirë në vendimmarrje”.

8. “Zyrtari i lartë nuk duhet të lejoj që interesat e tij private të bien në konflikt me funksionin e tij. Ai duhet të shmang konfliktin e interesit pavarësisht nëse ai është real, apo i mundshëm”.

Duke u bazuar në këto që u thanë më lartë, zyrtari i lartë z. Bahri Nuredini nuk ka ndërmarrë veprime me qëllim të parandalimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesit.

II. Sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e funksionit Publik (Nr.04/L-051) Neni 20, pika 1, “çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, kur nuk paraqet vepër penale, paraqet kundërvajtje dhe dënohet me gjobë sipas kufijve të përcaktuara në paragrafin 1.1, 1.2 dhe 1.3”.

III. Sipas Nenit 18 paragrafi 12, të gjitha Vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në ueb faqen zyrtare të Agjencisë.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./ znj. (zyrtari ndihmës)

Shaip Havolli
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

